

VENDIM
Nr. 381, datë 6.5.2015

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË FORUMIN EKONOMIK TË VJENËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Forumin Ekonomik “Vienna Economic Forum-Tirana Talks 2015”.
 2. Autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për mbulimin e shpenzimeve të organizimit të këtij Forumi, në shumën 23 000 (njëzet e tre mijë) euro.
 3. Ky fond të përballohet nga buxheti i planifikuar për këtë Agjenci, për vitin 2015.
 4. Lejohet AIDA të transferojë këtë fond në llogarinë e Forumit Ekonomik të Vjenës.
 5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama